| **Të dhëna bazike të lëndës: Gjinia dhe Diversiteti** | |
|---|---|
| **Njësia akademike:** | **Departamenti Punë Sociale** |
| **Titulli i lëndës:** | **Gjinia & Diversiteti** |
| **Niveli:** | **BA** |
| **Statusi lëndës:** | **Obligative** |
| **Viti i studimeve:** | **III** |
| **Numri i orëve në javë:** | **3+2** |
| **Vlera në kredi – ECTS:** | **6 ECTS** |
| **Koha / lokacioni:** | **E Martë\| 10:30-12:45\| Salla #109** |
| **Mësimëdhënësja e lëndës:** | **Prof. Asoc. Dr. Vjollca Krasniqi** |
| **Detajet kontaktuese:** | **vjollca.krasniqi@uni-pr.edu** |
| **Konsultimet** | **E Hënë 09:30-10:30** |
| | |
| **Përshkrimi i lëndës** | Gjinia dhe Diversiteti është lëndë një semestrale. Kjo lëndë ofron një trajtim të teorive gjinore. Lënda ka për fokus çështjet dhe shënjuesit e identitetit të grupeve të ndryshme shoqërore, si dhe pozicionet e tyre në stukturën shoqërore; përfshirjen dhe përjashtimin. Lënda synon të kuptojë se si fuqia dhe gjinia jo vetëm që karakterizojnë dhe ndërtojnë përvojën njerëzore, por poashtu formësojnë kuptimet kulturore, grupet dhe proceset shoqërore, dhe identitetet. Kjo lëndë shqyrton koncpetualizimin dhe analizat gjinore të shtetit, familjes dhe tregut. |
| **Qëllimet e lëndës:** | 1. Të kuptojmë terminologjinë esenciale dhe supozimet qendrore mbi gjininë dhe diversitetin.<br>2. Të arrijmë njohuri në studimet gjinore dhe konceptimet mbi diversitetin dhe ndërthurjes së gjinisë me relacionet tjera shoqërore të pushtetit<br>3. Të inkurjajomë studentët të aplikojnë perspektivat nga studimet gjinore dhe të diversitetit në praktikë në studimin e institucioneve dhe veprimit për ndryshim shoqëror. |
| **Rezultatet e pritura të nxënies:** | Studentët në përfundim të lëndës do të mund të:<br>• Njohin pozicionet e ndryshme në debatet akademike në studimet gjinore dhe ato të diversitetit.<br>• Demonstrojnë vetëdije kritike për natyrën e spjegimeve dhe teoretizimeve në studimet gjinore.<br>• Aplikojnë perspektiva nga teoritë gjinore dhe të diversitetit në studimet në punën sociale. |

| Kontributi në ngarkesën e studentit/es | | | |
|---|---|---|---|
| **Aktiviteti** | **Orë** | **Ditë/javë** | **Gjithësej** |
| Ligjërata | 2 | 15 | 30 |
| Ushtrime teorike/laboratorike | 1 | 15 | 15 |
| Punë praktike | 1 | 7 | 7 |
| Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet | 1 | 15 | 15 |
| Ushtrime në teren | | | |
| Kollokfiume, seminare | 1 | 15 | 15 |
| Detyra të shtëpisë | | | |
| Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi) | 2 | 15 | 30 |
| Pregaditja përfundimtare për provim | 2 | 15 | 30 |
| Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final) | 1 | 1 | 1 |
| Projektet, prezentimet, etj. | 1 | 7 | 7 |
| **Totali** | | | **150** |

| | |
|---|---|
| **Metodologjia e mësimëdhënies:** | **Mësimi:** Ligjëratë dy orë dhe një ushtrime. Ligjëratat dhe ushtrimet – do të ofrojnë një forum për eksplorim, debat dhe shkëmbim të ideve për çështjet e trajtuara në literaturë. Nga studentë pritet të kenë lexuar së paku një tekst me qëllim të pjesëmarrjes në diskutim. Çdo javë nga studentët do të kërkohet të bëjnë nga një prezantim të shkurtër, jo formal për studentët në grup. **Puna në lëndë –** studentët do të pregadisin prezantime nga temat e shqyrtuara në këtë lëndë. |
| **Metodat e vlerësimit:** | **VLERËSIMI** - Kjo lëndë vlerësohet përmes dy kollokfiumeve (90% e notës përfundimtare) dhe pjesëmarrjes aktive në lëndë (10%). |
| **Literatura** | |
| **Literatura bazë:** | **1.** Masculinities, **R.W. Connell**, Cambridge, Polity Press, 1995.<br>**2.** Domestic Violence: Gendered State Rationality and Women's Activism in Kosovo", **Vjollca Krasniqi**, në Martin Auferbauer et al. (eds.) *Social Development: Ways of Understanding Society and Practicing Social Work*, Social Issues, Berlin-Münster-Wien-Zürich-London: Lit Verlag, 2019.<br>**3.** Mapping the Margins: Intersectionality, Identity Politics, and Violence Against Women of Color, **Kimberlé Williams** |

| | |
|---|---|
| | **Crenshaw,** në https://www.racialequitytools.org/resourcefiles/mapping-margins.pdf<br>**4.** *Living a Feminist Life*, A killjoy Manifesto, Sarah Ahmed, Duke University Press, Durham dhe Londër, 2017.<br>**5.** *Feminizmi është për të gjithë:* Politika të Zjarrta, **bell hooks**, Instituti për Studime Politike dhe Ligjore, Tiranë, 2000.<br>**6.** *Feminizëm, Menizëm, a Humanizëm, podcast,* *https://www.youtube.com/watch?v=PXTPk92xfAY&t=1980s*<br><br>**<u>Ligjet & Konventat</u>**<br>1. Ligji për Barazi Gjinore, gjendet në https://abgj.rks-gov.net/assets/cms/uploads/files/LIGJI_NR._05_L-020_PËR_BARAZI_GJINORE.pdf<br><br>2. Ligji për mbrojtje nga diskriminimi, gjendet në https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=10924<br><br>3. Ligji për mbrojtje nga dhuna në familje, gjendet në https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2691<br><br>4. Konventa CEDAW, gjendet në https://hrrp.eu/alb/docs/CEDAw-a.pdf<br><br>5. Konventa e Stambollit, gjendet në https://rm.coe.int/168064d3f6 |
| **Literatura shtesë:** | 1. *The Feminist Standpoint Theory Reader.* **Sandra Harding** (redaktore), Routledge, New York, 2004.<br>2. Agency and Experience: Gender as a Lived Relation, **Lois McNay**, *The Sociological Review* 52, 2: 175–190 (2004).<br>3. *Stereotipet dhe Rolet Gjinore,* **Susan A. Basow**, Dituria, Tiranë. |
| | |

| **Plani i dizejnuar i mësimit:** | |
|---|---|
| **Java** | **Ligjëratat që do të zhvillohen** |
| ***Java e parë:*** | Hyrje në Studimet Gjinore dhe Diversitetin |
| ***Java e dytë:*** | Gjinia si Kategori Analitike |
| ***Java e tretë*:** | Epistemologjitë Feministe |
| ***Java e katërt:*** | Ndërthurja dhe Ndërvarësitë |
| ***Java e pestë:*** | Çka është feminizmi? Valët e Feminizmit |
| ***Java e gjashtë*:** | Përjashtimi në Bazë Gjinore |
| ***Java e shtatë:*** | Teoritë e Maskulinitetit |
| ***Java e tetë:*** | ***Kollokfiumi #1*** |
| ***Java e nëntë:*** | Gjinia dhe Familja |
| ***Java e dhjetë:*** | Legjislacioni dhe Mekanizmat e Barazisë Gjinore në Kosovë |
| ***Java e njëmbedhjetë*:** | Dhuna në Familje |
| ***Java e dymbëdhjetë*:** | Trupi dhe Teoritë Gjinore |
| ***Java e trembëdhjetë*:** | Tregu dhe Puna e Grave |
| ***Java e katërmbëdhjetë*:** | ***Kollokfiumi #2*** |
| ***Java e pesëmbëdhjetë*:** | Përmbledhje dhe vlerësimi |

**Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:**

**Vijimi**–vijimi i lëndës është **i detyrueshëm** për të gjithë studentët e regjistruar në këtë lëndë dhe studentët të cilët nuk kanë vijuar lëndën, normalisht nuk do të iu lejohet dalja në provim. Sipas regullave të Fakultetit Filozofik dhe Universitetit të Prishtinës, do të mbahet regjistër i vijimit të lëndës.

**Leximi**–për çdo javë nga studentët pritet që të lexojnë së paku nga një tekst për çdo ligjëratë.